



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ATC Com shpk" të datës 25.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Eficienca e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-25-1467-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ATC Com shpk" të datës 25.03.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Eficienca e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-25-1467-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ATC Com shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 25.03.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Eficienca e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-25-1467-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit:

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

Ne si kompani kerkojme qe te nderrohet profesioni i menaxherit te projektit pasi qe ne base te paramases e gjithë puna ne kete projekt ka te beje me ARKITEKTUR , kurse asgje ska te beje me MAKINERI , pra kerkojme qe kerkesa e pikes d) te nderrohet nga ingjinjer i Makinerir ne Ing. Te Arkitektures.

- Gjithashtu sa u perket deshmive qe duhet te ofrohen lidhur me referenca "hartimin e politikave te energjise si PVKEQ ose PVKEK për sektor rezident ne Komuna" duhet te shtohen edhe hartimi i politikave te energjise se PKEE , pasi qe jane natyre e njejte, kurse gjat vleresimit mund te mos pranohet nese nuk ceket ne dosje.
- Kurse sa i perket Certifikimit per softwer ne perputhje me ligjin 08 l-242 , ne e dijm qe ky ligj ka hyre ne fuqi me date 12.06.2024 , a pranohen edhe certifikimet me te vjetra me date qe jane bere me softwerin e njejte ISBEMXX, nese jo , atehere ky kriter ne baset te ketij ligji duhet te largohet.

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

- Sa u perket deshmive qe duhet te ofrohen lidhur me referenca "hartimin e politikave te energjise si PVKEQ ose PVKEK për sektor rezident ne Komuna" duhet te shtohen edhe hartimi i politikave te energjise se PKEE , pasi qe jane natyre e njejte, kurse gjat vleresimit mund te mos pranohet nese nuk ceket ne dosje.
- Kurse sa i perket Certifikimit per softwer ne perputhje me ligjin 08 l-242 , ne e dijm qe ky ligj ka hyre ne fuqi me date 12.06.2024 , a pranohen edhe certifikimet me te vjetra me date qe jane bere me softwerin e njejte ISBEMXX, nese jo , atehere ky kriter ne baset te ketij ligji duhet te largohet.

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

- Sa u perket deshmive qe duhet te ofrohen lidhur me referenca duhet te perfshihen e hartimi i politikave te energjise se PKEE ,
- Sa i perket softwerit EPCSoftwareKosovo , duhet te shtohet edhe sftweri ISBEMXX , pra ingjinjeri mund te jete i certifikuar ose ne EPS ose ne ISBEMXX , pra dy softwer qe mund te kryejn pune.
- Kurse sa i perket Certifikimit per softwer ne perputhje me ligjin 08 l-242 , ne e dijm qe ky ligj ka hyre ne fuqi me date 12.06.2024 , a pranohen edhe certifikimet me te vjetra me date qe jane bere me softwerin e njejte ISBEMXX, nese jo , atehere ky kriter ne baset te ketij ligji duhet te largohet.

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

- Sa u perket deshmive qe duhet te ofrohen lidhur me referenca duhet te perfshihen e hartimi i politikave te energjise se PKEE ,
- Sa i perket softwerit EPCSoftwareKosovo , duhet te shtohet edhe sftweri ISBEMXX , pra ingjinjeri mund te jete i certifikuar ose ne EPS ose ne ISBEMXX , pra dy softwer qe mund te kryejn pune.
- Kurse sa i perket Certifikimit per softwer ne perputhje me ligjin 08 l-242 , ne e dijm qe ky ligj ka hyre ne fuqi me date 12.06.2024 , a pranohen edhe certifikimet me te vjetra me date qe jane bere me softwerin e njejte ISBEMXX, nese jo , atehere ky kriter ne baset te ketij ligji duhet te largohet.

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

- Duhet te largohet komplet ky kriter , pasi qe qka ka te beje nje ekonomist per pune arkitektonike dhe ndertimore , ky kriter eshte vendosur vetem e vetem qe te zvoglohet konkurenca , dhe te iu rregullohet nje operatori te caktuar.

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

- Sa i perket ing. Te mjedisit , nese ky ing. Ofrohet me diplome si ing. I mjedisit , pse duhet te jete i certifikuar me VNM , pra kerkojme qe certifikata per kete ing. Te mos kerkohet .
- Sa u perket deshmive qe duhet te ofrohen lidhur me referenca duhet te perfshihen e hartimi i politikave te energjise se PKEE ,

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

- Duhet te largohet komplet ky kriter , pasi qe siq e cekem edhe me larte asnje pune ska te beje me makineri ne kete kontrate, e aq me pak me salldim.
- Mund te kerkohet nje ingjinjer i ciles do lami i certifikuar per siguri dhe shendet ne pune , mirpo jo decidivisht i makineris plus i certifikuar per salldim.

Kerkesa e jone lidhur me kete kriter :

- Sa i perket ketij pozicioni mund te kerkohen kataloge dhe atestet , mirepo pse duhet te kemi nje autorizim original nga prodhuesi , pra autorizimi duhet te largohet pasi qe e minon konkurencen , se ndonje O.E. mund ta kete nje autorizim dhe te tjeret nuk mund ta marrin, kurse keto produkte mund te blihen prej secilit person.

Lidhur me pretendimet ankimore duhet fokusuar faktin që parashtruesi thirret në faktin që kërkesat aktuale në DT janë kinse diskriminuese dhe njëkohësisht në shumicën e pretendimeve ankimore kërkohet që të shtohen apo që të ndryshohen kërkesat e DT duke u ashpërsuar të njëjtat. Sa i përket kërkesës së fundit ku kërkohet autorizimi i prodhuesit, kjo kërkesë është e domosdoshme për të siguruar origjinalitetin dhe kualitetin e produkteve që do të liferohen si dhe shmangien të gjitha rreziqeve të mundshme për liferimin e imitimeve apo falsifikimeve të produkteve në fjalë. Sa i përket kërkesës së parafundit, kjo kërkesë është po ashtu e domosdoshme për realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Po ashtu të gjitha kërkesat për stafin profesional dhe çertifikimet përkatëse janë të domosdoshme për të siguruar realizimin e kontratës në mënyrë cilësore dhe profesionale me nivel të lartë të efikasitetit dhe efektivitetit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.04.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.